

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"TEKNO CNC" SH.P.K.

Sot, më date **05.04.2021**, ne te nënshkruarit:

- **Ariol Lluga** lindur me 20/08/1992, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, mbajtes i leternjoftimit nr.033756829, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- **Ronald Lluga** lindur me 24/09/1995, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje dhe me rezidence ne Lushnje, mbajtes i leternjoftimit nr.033376898, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar...; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "TEKNO CNC" SH.P.K. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: "TEKNO CNC" SH.P.K.

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lushnje, Plug pasuria me nr.1/231 e ndodhur ne zonen kadastrale me nr.2999 .

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: teknocnc.albania@gmail.com

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.



Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- a. Tregtim aksesore alumini dhe plastik, punime alumini .Prodhim stampa çeliku per plastik dhe alumin, punim torno, freze CNC, etj.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.



Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2 000 000 (dy milion) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Z. Ariol Lluga**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 1 000 000 (nji milion) Leke që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Z. Ronald Lluga**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 1 000 000 (nji milion) Lekë që përbën 50% te kapitalit themeltar te shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakëve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithe ortakët jane te detyruar qe ta repektojnë dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asamblese

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me te drejten e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.


Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.


Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakëve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ariol Lluga


Ronald Lluga


Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përfundimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise emerohet Z. **Ariol Lluga** lindur me 20/08/1992, shtetas shqiptar,lindur ne Lushnje dhe me residence ne Lushnje, mbajtes i leternjoftimit nr.033756829, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitet e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqerise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë


Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqerise jane te percaktuara ne statutin e shoqerise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Ariol Lluga



Ronald Lluga

